

VENDIM
Nr. 319, datë 29.5.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 782, DATË 7.10.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E MODELEVE TË AKTEVE KADASTRALE DHE TË DHËNAVE NË PËRMBAJTJE TË HARTËS KADASTRALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 5, 15, pika 3, e 17, pika 7, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 782, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale", bëhen këto ndryshime:

1. Fjalja e dytë, e pikës 24, të kreut V, "Akte të tjera kadastrale" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Këto vërtetime provojnë se pronari ka depozituar dokumentet ligjore për regjistrim, por prona ndodhet në një zonë kadastrale që nuk i është nënshtruar ende regjistrimit fillestar. Ky vërtetim është i vlefshëm për përdorim nga pronari dhe autoritetet publike deri në përfundimin e procesit të regjistrimit fillestar. ASHK-ja garanton statusin juridik të pasurisë së paluajtshme vetëm pas përfundimit të regjistrimit fillestar sistematik të zonës kadastrale ku ndodhet pasuria."

2. Aneks 7 dhe 8, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me anekset me të njëjtin numërtim dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Aneks 7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
VËRTETIM

Ky vërtetim lëshohet bazuar në nenin 19, pika 2, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", për të provuar se pronari ka depozituar dokumentet ligjore për regjistrim, por prona ndodhet në një zonë kadastrale që nuk i është nënshtruar ende regjistrimit fillestar. Ky vërtetim është i vlefshëm për përdorim nga pronari dhe autoritetet publike deri në përfundimin e procesit të regjistrimit fillestar. ASHK-ja garanton statusin juridik të pasurisë së paluajtshme vetëm pas përfundimit të regjistrimit fillestar sistematik të zonës kadastrale ku ndodhet pasuria.

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri (emër, atësi dhe mbiemër)/emri i personit juridik	Numër personal ID-je/NIPT-i	Pjesa (-/-)

Nr. jopërfundimtar i pasurisë	
Zona kadastrale	

Lloji i pasurisë				
Sipërfaqja e pasurisë	Total:	Truall:	Ndërtesë:	
Kufitarët (nëse ka)	Në veri:	Në lindje:	Në jug:	Në perëndim:
Vlera aktuale e pasurisë				
Adresa e pasurisë				
Komente				

DREJTORI:

(emër, mbiemër)

Data e lëshimit ____/____/____

Nr. serialit _____



Shënim. Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistemin elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës).

Aneks 8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS VËRTETIM

Ky vërtetim lëshohet bazuar në nenin 19, pika 2, të ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, për të provuar se subjekti është përfitues i të drejtës reale, por prona ndodhet në një zonë kadastrale që nuk i është nështruar ende regjistrimit fillestar. Ky vërtetim është i vlefshëm për përdorim nga pronari dhe autoritetet publike deri në përfundimin e procesit të regjistrimit fillestar. ASHK-ja garanton statusin juridik të pasurisë së paluajtshme vetëm pas përfundimit të regjistrimit fillestar sistematik të zonës kadastrale ku ndodhet pasuria.

PËRFITUESI I SË DREJTËS (qiramarrës, enfiteozëmarrës, kreditor, hipotekor etj.)	
Emri (emër, atësi dhe mbiemër)/emri i personit juridik	Numër personal ID-je/NIPT-i

Nr. jopërfundimtar i pasurisë				
Zona kadastrale				
Lloji i pasurisë				
Sipërfaqja e pasurisë				
Kufitarët (nëse ka)	Në veri:	Në lindje:	Në jug:	Në perëndim:
Afati i të drejtës				
Adresa e pasurisë				
Pronari/bashkëpronarët (qiradhënës, enfiteozëdhënës etj)	Emri (emër, atësi dhe mbiemër)/emri i personit juridik	Numër personal ID-je/NIPT-i	Pjesa (_/_)	

DREJTORI:

(emër, mbiemër)

Data e lëshimit ____/____/____

Nr. serialit _____



Shënim. Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistemin elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës).